



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 15.06.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.06.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.T.P. " Beni ", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve", me Nr. të Prok: 632-20-1237-5-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik N.T.P. " Beni ", e dt. 12.06.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve", me Nr. të Prok: 632-20-1237-5-2-1, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK –së, të datës 11.06.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së .

2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 11.06.2020;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik N.T.P. " Beni ", me datë 12.06.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve", me Nr. të Prok: 632-20-1237-5-2-1,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 15.06.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Lista e kontratave –referencave ose certifikatave për kryerjen e punëve e prezantuar nga ju, nuk përmbush vlerën e kërkuar në dosjen e tenderit nga Autoriteti kontraktues, prandaj bazuar në nenin 59 paragrafi 4 i LPP-së, oferta juaj refuzohet pa kërkuar informacione të mëtejshme.

Pas rishikimit të dokumenteve, autoriteti Kontraktues, konstaton se Operatori Ekonomik NNSH “Korben” i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është eliminuar për arsye se nuk plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës